

FJALË PËRSHËNDETËSE

DRITËHIJE

E zeza dhe e bardha të mpleksura me njëra tjetrën. Mister dhe sekrete. Gjethe që mbulojnë dritën e diellit dhe krijojnë hije. Rreze drite që arrijnë të depërtojnë. Hije që zgjaten e përpiqen të mbulojnë sa munden.

Imazhe gri të muzeut Kombëtar të Përgjimeve: “Shtëpia me Gjethe”. Sektorë me pamje, filmime, dokumente dhe fotografi, me dritëhije ku e zeza shërben si shenjim i misterit dhe i sekreteve që bart godina.

Jemi të lumtur që kemi mbërritur të nxjerrim në dritë numrin e tretë të *Dritëhijes* tonë, ku kemi disa prurje të reja e kontribues të rinj.

Në këtë numër sjellim një artikull mbi Panoptikën. Panoptika është një lloj arkitekture burgu e konceptuar nga filozofi utilitarist Jeremy Bentham dhe nga i vëllai, Samuel Bentham, në fund të shekullit XVIII. Qëllimi i strukturës panoptike ishte që t’i lejonte një gardiani, të vendosur në një kullë qendrore, të vëzhgonte të gjithë të burgosurit e mbyllur në qeli individuale përreth kullës, pa u vënë re prej tyre. Artikulli përpiqet të tregojë se si

pushtetet totalitare dhe ai komunist në Shqipëri e përdorën këtë mekanizëm por në të njëjtën kohë tërheq vëmendjen për më shumë vigjilencë, në kushtet kur kontrolli përmes rrjeteve sociale është bërë mjaft i pranishëm sepse teknologjia ka lejuar vendosjen e strukturave panoptike në mënyrë të padukshme në të gjithë shoqërinë moderne.

Dr. Oltsen Gripshi sjell punimin: “Muzeologjia shqiptare midis muzeut socialist dhe muzealizimit të trashëgimisë komuniste pas ’90” ku synon evidentimin e çështjeve të ndryshme muzeologjike, konceptit të muzeut socialist si shpërndarës i një propagande monopoliste diktatoriale para viteve ’90 dhe muzealizimin e trashëgimisë komuniste shqiptare brenda vetë hapësirave të atyre godinave sot, duke marrë si pikënisje përkufizimin e muzeut nga Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve.

Alma Mile sjell një artikull me vlerë mbi historikun, përndjekjen dhe mbijetesën e një prej revistave kulturore më të rëndësishme të gjysmës së parë të shek. XX: revistës “Hylli i Dritës”. E themeluar nga At Gjergj Fishta dhe e botuar nga katolikët e urdhrit françeskan, në të shkruan shkrimtarë, poetë e studiuesit më të njohur të kohës. Në artikull tregohet se si revista u censurua nga politika gjatë regjimit të Mbretit Zog, por që kulmoi gjatë regjimit komunist.

Censura në Shqipëri gjatë diktaturës komuniste është në qendër të punimit të Bruna Priftit. Në të tregohet se si emra të rëndësishëm të letërsisë. Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Faik Konica, Zef Skiroi etj., mbetën jashtë

historisë së letërsisë gjatë gjithë periudhës komuniste. Vepra e tyre nuk u bë pjesë studimi në arsimin e detyruar apo atë të lartë në vend, duke shkatërruar kështu hierarkinë e vlerave, duke e deformuar historinë e duke krijuar boshllëqe në njohuritë e nxënësve. Në këtë punim znj. Prifti bën një krahasim të pasqyrimin të këtyre penave të rëndësishme të letërsisë shqipe në tre tekste, dy zyrtare akademike (1959, 1983), prej nga rrodhën edhe të gjitha tekstet për nivelet arsmore më të ulëta, si dhe një teksti (1968) të mbetur në bocet e që nuk e pa kurrë dritën e botimit.

Ndërhyrja e shtetit komunist edhe në jetën private të qytetarëve, duke diktuar emrat që u viheshin atyre trajtohet në artikullin e Andrea Llukanit. Në të flitet për një dekret të vitit 1975 "Mbi ndërrimin e emrave dhe të mbiemrave të papërshtatshëm". Nëpunësit e gjendjeve civile, u urdhëruan të kontrollojnë nëpër regjistra gjithë emrat dhe mbiemrat e papërshtatshëm. Megjithatë në artikull tregohet se pavarësisht propagandës ateiste, besimi te Zoti mbeti gjallë në shpirtin e popullit dhe si u rezistua me veprime konkrete.

Gjergj Totozani vjen në këtë numër me një artikull mbi tranzicionin, procesin historik gjatë të cilit shoqëritë ish-komuniste kryejnë transformimet radikale të regjimit politik dhe ekonomik socialist në atë të demokracisë pluraliste dhe të ekonomisë së tregut. Duke përshkruar tranzicionin në Rusi nga Jeltsin tek Putin, ai bën një paralelizëm me Shqipërinë.

Ndërsa Nashifere Mëhalla Brooker sjell në këtë botim artikullin: “Sigurimi i Shtetit”, arma për mbrojtjen e “revolucionit komunist”, në të cilin bën një historik të shkurtër të krijimit të shërbimit informativ sekret në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe tregon për natyrën repressive e eliminimet politike të kryera prej tij.

Duke gërmuar thellë në kërkim të së vërtetës, misteret e realitetit zbulohen papritur, me prekje të vogla të njëpasnjëshme; spiralja e ankthit ngecet në vend dhe drita e dijes, duke grisur errësirën e padepërtueshme, tregon rrugën dhe pastaj ndriçon punën që duhet bërë. Falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët tanë për kontributin e tyre në ndihmë të dritës.

Dr. Etleva Demollari

Drejtor i Muzeut Kombëtar të Përgjimeve

“Shtëpia me Gjethe”